

## NJOFTIM PËR KONTRATË

*Punë*

*Procedurë e hapur*

*Në përputhje me Nenin 6 të Rregullave të Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës*

Data: 07.02.2019

Nr. i Prokurimit: BQK 19 006 321

### I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Personi kontaktues: Genta Islami	E-mail: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/451.	Fax: 038 243 763

### II LËNDA E KONTRATËS

#### II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: : <b>“Renovimi i Anexit”</b>
Lloji i prokurimit: Punë
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): n/a
Variantet pranohen: n/a
Ndarja në Pjesë: JO

### III INFORMACIONE PËR FURNIZIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është që të përzgjidhet kontraktuesi për të realizuar këtë kontratë që të kryejnë në mënyrë profesionale punët e Renovimit të Anexit në objektin e BQK-së , sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike / paramasa dhe paralogaria ofertuesit te interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do tu shpërndahet.

### IV KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me aplikacionet e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	<u>Kërkesa 1</u> : Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.
--------------------------------------	---

	<p><b>Evidenca 1:</b> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin 3 të dosjes së tenderit.</p> <p><b>Kërkesa 2:</b> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><b>Evidenca 2:</b> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmerinë e tyre.</p>
Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale	<p><b>Kërkesa 3:</b> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><b>Evidenca 3:</b> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p>
	<p><b>Kërkesa 4 :</b> Regjistrimi i Numrit Fiskal për kompanitë vendore.</p> <p><b>Evidenca 4:</b> Kopje e certifikatës së numrit fiskal</p> <p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre.</p>
	<p><b>Kërkesa 5:</b> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjtë gjate 3 (tri) viteve të fundit (2016-2017-2018), jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës (në rast të konzorciumit këtë kusht duhet ta plotësoj kompania lidere.</p> <p><b>Evidenca 5:</b> Ofertuesi duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose referencat qe evidentojnë performimin e tillë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kërkesa 6 :</b> Ofertuesit duhet të dorëzojnë Katalogët - me specifikat teknike detale të artikujve të ofruara për këto materiale kryesore: <ul style="list-style-type: none"> <li>- paisje klimatizuese</li> <li>- instalimet elektrike dhe IT</li> <li>- pajisje të sanitarisë dhe dyer e dritare.</li> </ul> </li> </ul> <p><b>Evidenca 6:</b> Katalogët - me specifikat teknike të artikujve të ofruara dhe e shënjuar ne katalog qarte produktet e ofruara, ashtu siç janë kërkuar</p> <p><b>Kërkesa 7:</b> Mesatarja vjetore e të punësuarve (që janë në listën e pagave) në tri vitet e fundit duhet të jetë minimum 30 të punësuar (vlen vetëm për kompaninë liderë të konzorciumit kur aplikohet)</p> <p><b>Evidenca 8:</b> Ofertuesi duhet të ketë stafin e përfshirë në projekt, Personeli kryesor teknik: Menaxheri i projektit: Të jetë inxhinier i diplomuar: 5 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy 2 projekte nga lëmi e</p>

	<p>kërkuar</p> <p>Një udhëheqës të punishtes i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me 3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të objekteve të natyrës së njëjtë. Të jetë në listën e pagave së paku në gjashtë mujorin e fundit të vitit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Një inxhinier i Arkitekture – 5 vite përvojë pune</li> <li>- Një inxhinier i Makinerisë – 5 vite përvojë pune</li> <li>- Një inxhinier i Elektrikes – 5 vite përvojë pune</li> <li>- Një inxhinier i Hidro Teknikës – 5 vite përvojë pune</li> </ul> <p><b><u>Kërkesa 8:</u></b> Të dorëzohen CV, diplomat së bashku me dëshmitë e përvojës</p>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	<p><b><u>Kërkesa 9:</u></b> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të renovimit të objekteve afariste përgjatë tri (3) viteve të fundit (2016-2018), Minimumi 3 (tri) referenca përgjatë tri viteve të fundit.</p> <p><b><u>Evidenca 9:</u></b> Ofertuesi duhet të bashkëngjisë kopjet e kontratave dhe certifikatat përkatëse ose referencat që evidentojnë përfundimin e tillë për renovim të objekteve afariste.</p>
	<p><b><u>Kërkesa 10:</u></b> Ofertuesi duhet të jetë i akredituar sipas ISO Standardeve 9001 për kompanitë e licencuara për ndërtim</p> <p><b><u>Evidenca 10:</u></b> Çertifikata që është në pajtueshmëri me standardet ISO-9001</p> <p><b><u>Kërkesa 11:</u></b> Ofertuesit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e menaxhimit të projektit, duke përfshirë vendosjen e ekipeve në çdo aktivitet, kohën e fillimeve dhe kompletimit të aktiviteteve dhe zbatimit të përgjithshëm të projektit.</p> <p><b><u>Evidenca 11</u></b> Të dorëzohet plani Dinamik sipas kërkesave minimum 60 ditë pune.</p>
III.1.3) Inspektimi i kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale	<p>Banka Qendrore mund të dëshirojë, me shpenzimet e tij, të kryej një inspektim të operatorëve ekonomik tenderues për qëllime të verifikimit të kapacitetet disponuese vërtetimin e cilësisë, mjetet për transport dhe çdo informatë tjetër që janë të nevojshme që mund të dëshmojë që ofertuesi mund të realizoj kontratën</p>

## V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: E hapur

## VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS:

Tenderi i përshtatshëm me çmimin Ekonomikisht të përshtatshëm me këto nënkritere:

Nën-kriteri	Pesha (në %)
(a) Çmimi	60
(b) Referencat e kompanisë ofertuese për punë të ngjashme në 3 vitet e fundit ( Do të konsiderohen vetëm referencat për renovimin e objekteve afariste. Vlera e secilës nga tri (3) referencat gjatë tri viteve të fundit duhet të jetë sa çmimi i ofertës ose më e lartë)	30
(c) Afati i implementimit të projektit, jo më i vogël se 60 ditë pune.	10
<b>TOTAL</b>	<b>100</b>

## VII INFORMATA ADMINISTRATIVE

Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit : afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit 21.02.2019, ora 14:00 në e-mail adresën <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 25.02.2019, ora 14:00
Dokumentet me pagesë: Jo
Siguria e tenderit: 3000.00 Euro ( me vlefshmëri 90 dite, nga data e hapjes së ofertave)
Sigurimi i kontratës: 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditë më shumë se sa afati i liferimit.
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e hapjes
Afati i fundit i dorëzimit të aplikacioneve : 27.02.2019, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.
Takimi për hapjen e aplikacioneve: 27.02.2019, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.

## VIII INFORMATA PLOTËSUESE

### VIII.1 ANKESAT

Në përputhje me Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, respektivisht Neni 41 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore.
---

### VII.2 ADRESA

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Personi kontaktues: Genta Islami	E-maili: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/451	Fax: 038 243 763

## NJOFTIM:

**KOMPANIT E INTERESUARA PËR PJESËMARRJE NË TENDER MUND TË BËJNË VIZITËN E OBJEKTIT ME DATË: 22.02.2019 Në ORA 10:00.**

**PËR VIZITËN E OBJEKTIT DUHET TË PARALAJMEROHET ARDHJA.**